



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2021:128759

Datë: 31.01.2022

Numri i dokumentit: 02662481

Ac.nr.10352/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Zenel Leku-kryetar i kolegjit, Rustem Thaqi dhe Faton Ademi - anëtarë, në çështjen juridike kontestimore të paditësit – propozuesit të sigurimit H.TH nga fshati N.. – Komuna e Prizrenit, përfaqësuar sipas autorizimit nga B.K, avokat në Prizren, kundër të paditurve – kundërshtarëve të sigurimit S.K, Sh.K, H.K, që të tre nga fshati N., Komuna e Prizrenit dhe E.B nga fshati G., Komuna e Prizrenit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson P.P, avokat në Prizren, lidhur me çështjen juridike të propozimit për caktimin e masës së sigurisë, në bazë të ankesës të autorizuarit të së paditurit – kundërshtarit të sigurimit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i përgjithshëm, C.nr.1235/21, datë 27.10.2021, në seancë e kolegjit të mbajtur me datë 28.01.2022, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e paditësit-propozuesit të masës H.TH nga fshati N.. – Komuna e Prizrenit, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i përgjithshëm, C.nr.1235/21, datë 27.10.2021, VËRTETOHET.

**A r s y e t i m**

Me aktvendimin e ankimuar C.nr.1235/21, datë 27.10.2021, gjykata e shkallës së parë ka vendosur si në vijim: *“I. Refuzohet si i pa bazuar propozimi i palës paditëse – kundër të paditurit H.TH nga fshati ..., Komuna e Prizrenit për caktimin e masës së sigurisë, me të cilën ka kërkuar që të “urdhërohen dhe i ndalohet të paditurit E.B nga fshati G., Komuna e Prizrenit, shitja, tjetërsimi dhe çdo ndryshim i gjendjes faktike dhe juridike në palujtshmërinë që është e regjistruar si ngastër kadastrale, nr. i njësisë kadastrale 504-0, në sipërfaqe prej 9.1113 m2,*

*Zona Kadastrale Atmaxhë, e cila masë do të jetë në fuqi deri në zgjidhjen e kontestit, me aktgjykim të plotëfuqishëm nën kërcënim të pasojave juridike.*

*II. Procedura në këtë çështje juridike – kontestimore do të vazhdoj sipas rregullave të procedurës kontestimore dhe sipas planit të punës së gjykatës.”*

Kundër këtij aktvendimi në afat ligjor ka ushtruar ankesë i autorizuari i paditësit dhe atë për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta miratoj ankesën, ta ndryshoj aktvendimin ankimor, dhe të caktoj masën e sigurisë deri në përfundimin e procedurës kontestimore ose çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosije.

Ankesa i është dërguar në mënyrë të rregullt të autorizuarit të kundërshtarit të sigurimit, mirëpo i njëjti nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore, pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 194 të LPK-së gjeti se:

Ankesa e të autorizuarit të paditësit – propozuesit të sigurimit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi - propozuesi i sigurimit H.TH, ka ushtruar padi me datë 12.06.2021, ndaj të paditurve - kundërshtarëve të sigurimit S.K, Sh.K, H.K dhe E. B, me të cilën ka kërkuar vërtetimin e pronësisë, me propozim për caktimin e masës së sigurisë. Në përshkrimin e padisë është theksuar se paditësi H.TH në muajin Janar të vitit 2001 ka blerë palujtshmërinë këtu objekt kontesti nga paraardhësi i tre paditësve të parë, I.M, me pëlqimin e paraardhësit juridik të paditurit E.B, G. B, pëlqim ky i marrë për faktin se palujtshmëria figuronte në emër të këtij të fundit edhe pse pronar i ligjshëm ishte I.M. Paditësi ka theksuar se që nga momenti i blerjes së kësaj palujtshmërie është në shfrytëzim dhe posedim të saj, ku ka ndërtuar objekt me material të fortë dhe i shfrytëzon pa asnjë pengesë, duke shtuar se palujtshmëria këtu objekt i padisë, në bazë të trashëgimisë tani figuron në emër të paditurit E.B(nip i G.B) ku i njëjti heziton ta bartë në emër të paditësit duke kërcënuar se tani ai e ka pronën mbi vete. Në kuadër të padisë është propozuar masa e përkohshme, ku është kërkuar që të caktohet masa e sigurisë, me pretendim se meqenëse prona evidentohet në emër të paditurit E.B, në bazë të sjelljeve të tij ka lënë të kuptojmë se do ndërmerri veprime me qëllim të tjetërsimit të kësaj prone apo vënies në hipotekë. Andaj, është kërkuar që kundër propozuesit ti caktohej masa e sigurisë me ndalimin e tjetërsimit dhe çdo ndryshim i gjendjes faktike dhe juridike në palujtshmërinë që është e regjistruar si ngastër kadastrale, nr. i njësisë kadastrale 504-0, në sipërfaqe prej 9.1113 m2, Zona Kadastrale Atmaxhë, deri në përfundimin e procedurës kontestimore.

Gjykata e shkallës së parë ka mbajtur seancën e dëgjimit, ka dëgjuar palët dhe më pas ka vendosur në lidhje me masën e sigurisë të propozuar nga paditësi, ku me anë të aktvendimit C.nr. 1235/2021 të dt. 17.08.2021, ka refuzuar propozimin për caktimin e masës së sigurisë, duke vendosur më decidivisht sikur në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata e Apelit, duke vendosur lidhur me ankesën e të autorizuarit të paditësit – propozuesit të masës së sigurisë ndaj aktvendimit të lartcekur, ka nxjerrë aktvendimin Ac.nr.7294/2021 të dt. 01.10.2021, me të cilin ka aprovuar ankesën, aktvendimin e shkallës së parë e ka prish dhe çështjen ia ka kthyer të njëjtës gjykatë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Në ri procedurë, gjykata e shkallës së parë, pas mbajtjes së seancës me dt. 27.10.2021, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar, C.nr. 1235/21, me përmbajtje sikur në dispozitiv të të njëjtit.

Në arsyetim të këtij aktvendimi ka theksuar se pas analizimit dhe vlerësimit të provave ka ardhur në përfundim se propozimi i palës paditëse për caktimin e masës së sigurimit në këtë fazë të procedurës është i pa bazuar. Gjykata ka vërtetuar se ndërmjet punës juridike saktësisht aktvendimit mbi trashëgimin të lidhur pranë Noterit B.M LRP nr. 4421/021 dhe nr. i referencës 774/2021 të dt. 12.04.2021, i padituri – kundërshtari i sigurimit E.B është pronar në ngastrën kadastrale P – 71813001-00504-0, në sipërfaqe prej 9.113 m<sup>2</sup>, pra përmes kësaj prove ka konstatuar se paditësi nuk e ka bërë të besueshëm kushtin e parë të përcaktuar me nenin 297 par 1 pika a) e LPK –së, konkretisht provimi i së drejtës së tij subjektive lidhur me ngastrat kadastrale kontestuese. Po ashtu pretendimin e tij se i njëjti në janar të vitit 2001 ka blerë ngastrën kadastrale këtu objekt i padisë, ka vlerësuar si të pa bazuar dhe pa mbështetje në asnjë provë të propozuar apo vlerësuar nga ana e gjykatës. Duke marr parasysh vërejtjet e Gjykatës së Apelit gjeti se paditësi – propozuesi i masës me asnjë provë nuk e ka bërë të bërë të besueshëm pretendimin se i njëjti ngastrën kadastrale objekt kontesti e ka në posedim me mirëbesim dhe të ligjshëm, e aq më tepër se gjykata në këtë fazë të procedurës nuk mund të vendosë në mënyrë meritore lidhur me çështjen juridike kontestimore, ndërsa në përputhje me nenin 304 të LPK –së, është obligim i propozuesit të sigurimit që të bëjë të besueshëm pretendimin e tij lidhur me masën e sigurimit e që në këtë rast nuk ka ndodhur. Ka shtuar se edhe pse me certifikatën pronësore pala e paditur – kundërshtari i sigurimit evidentohet si pronar i ligjshëm, propozuesi i masës nuk ka ofruar prova që kundërshtari i sigurimit ka tentuar apo ka ndërmarrë ndonjë veprim me qëllim të shitjes, ngarkimit apo tjetërsimit të ngastrës kontestuese kadastrale. Gjithashtu nuk ka arritur të bëjë të besueshëm kushtin nga neni 297 par 1 pika b) e LPK –së, duke shtuar që nuk mjafton vetëm që pala të thirret në ekzistimin e rrezikut se pa caktimin e masës do të pamundësohet realizimi i kërkesës, por duhet të provoj këtë fakt me prova konkrete.

Në fund ka theksuar se edhe sikur gjykata ta merrte të bazuar apo besueshëm ekzistimin e rrezikut se pa caktimin e masës së sigurisë do të pamundësohet apo vështirësohet dukshëm realizimin e kërkesës, ka vlerësuar se kushtet për caktimin e masës së sigurisë (bërja e besueshme e drejtës së tij, ekzistimi i rrezikut real dhe pagimi i garancionit), të cilat duhet të përmbushen në mënyrë kumulative nuk janë plotësuar.

Gjykata e Apelit e pranon vlerësimin dhe përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar me ankesë nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, për të cilat Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e Apelit në tersi mbështet vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë sa i përket çështjes së vlerësimit të plotësimin të kushteve në mënyre komulative për caktimin e masës së sigurisë, ashtu siç është përcaktuar më nenin 297.1 nën (a) dhe (b) të LPK-së. Gjykata e shkallës së dytë në këtë rast çështjen e plotësimin të kushteve për caktimin në masës së sigurisë, e ka trajtuar në aspektin e ekzistimit të rrezikut për caktimin e masës së propozuar nga paditësi-propozuesi i masës, me vlerësim se propozuesi me asnjë provë dhe asnjë rrethanë nuk e kanë bërë të besueshme ekzistimin e ndonjë rreziku se pa caktimin e masës së sigurimit të propozuar atij do ti pamundësohet apo vështirësohet realizmi i kërkesës apo në ndonjë formë do të ndryshonte gjendja ekzistuese. Kjo gjykatë vlerëson se fakti që prona kontestuese aktualisht është e regjistruar në emër të kundërshtarit të sigurimit nuk paraqet rrezik real në raport me kërkesën e propozuesit dhe pronën kontestuese nga se çdo pronë ka një pronar dhe të qenit pronar nuk paraqet rrezik, por se rreziku duhet të ekzistojë dhe vlerësohet në raport me veprimet konkrete të ndërmarra në lidhje me atë pronë. Gjykata vlerëson se që nga koha e paraqitjes së padisë dhe të propozimit për masë të sigurisë, propozuesi nuk i ka paraqitur gjykatës asnjë provë madje as informacion për veprimet që do të mund të ketë ndërmarrë kundërshtari i sigurimit e që do ta rrezikonte ose pamundësonte realizmin e të drejtës së propozuesit të sigurimit në raport me paluajtshmërinë në fjalë. Nga këto arsye kjo gjykatë vlerëson se nuk janë plotësuar në mënyre komulative kushtet për caktimin e masës së sigurisë, ashtu siç është përcaktuar me nenin 297.1 nën (a) dhe (b) të LPK-së.

Gjykata e Apelit pa u lëshuar në shpjegime të mëtejme të cilat mund të prejudikojnë vendosjen meritorë për themelësinë e kërkesëpadisë, jep vlerësimin se aktvendimi i atakuar është i drejtë dhe i ligjshëm, por fakti se me aktvendimin e atakuar është refuzuar masa e sigurimit të kërkesëpadisë nuk nënkupton se vendosja meritorë nuk mund të jetë ndryshe, pasi që vendosja meritorë është rezultat i të gjeturave të gjykatës në shqyrtim kryesor, ku shqyrtohen të gjitha faktet dhe provat për të gjitha kërkesat/pretendimet dhe kundërshtimet.

Nga të cekurat më lartë, e në mbështetje të dispozitave nga nenet 208 dhe 209 pika (b) e LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

#### GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.10352/2021, me datë 28.01.2022

Kryetari i kolegjit,  
Zenel Leku